

Edukimi

Sa i përket arsimit në territorin e komunës së Medvegjës ekzistojnë: paralele të ndara të Fakultetit Ekonomik dhe atij Juridik nga Nishi, një shkollë e mesme Teknike "Nikolla Tesla", të cilën vijojnë 410 nxënës, 6 shkolla fillore:

- shkolla fillore "Jabllanica e epërme" në Medvegjë, të cilën vijojnë 528 nxënës dhe ka 50 punonjës,

- shkolla fillore "Radovan Kovaçević – Maksim" në Lec, të cilën vijojnë 70 nxënës dhe ka 25 punonjës,

- shkolla fillore "Shtëpia e partizanëve" në Buçumet, të cilën vijojnë 42 nxënës dhe ka 16 punonjës

- shkolla fillore "Zenel Hajdini", në Tupallë, të cilën vijojnë 36 nxënës dhe ka 15 punonjës,

- shkolla fillore "Vlladimir Bukilliq", në Tullarë, të cilën vijojnë 53 nxënës dhe 25 punonjës,

- shkolla fillore "Banja e Sjarinës" në Banjë të Sjarinës, të cilën vijojnë 112 nxënës dhe ka 49 punonjës.

Për qëndrim ditor të fëmijëve ekzistojnë institucione për fëmijë. Institucioni parashkollor "Mlladost" në Medvegjë, disponon me kapacitet prej 120 vendeve, ndërsa gjithsej punëson 26 punonjës.

Për qëndrim të fëmijëve jashtë Medvegjës janë formuar edhe paralelet e ndara të institucionit parashkollor "Mlladost" edhe atë në:

- Rujkoc,

- Tullarë,

- Banjë të Sjarinës,

- Lec,

- Gazdar,

- Negosavël,

- Buçumet,

- Retkocer,

- Maqedonc,

- Ramabajë,

- Kapit,

- Gjylekresht,

- Tupallë.